



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1260 Prot.

Tiranë, më 18/08/2025

VENDIM

Nr. 37, DATË 18/08/2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE
MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1, germa "1", në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenin 30, pika 3, gjerat "c" dhe "d" dhe nenin 34 të Statutit të Universitetit të Arteve; në nenin 21, pika 2, gjerat "c" dhe "d" dhe në nenin 26 të Rregullores së Universitetit të Arteve; në nenin 4, pika 1, germa "s" të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidatave për anëtarë në Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik (nga një anëtar për çdo fakultet të UART), 3 anëtarë përfaqësues të studentëve (nga një anëtar për çdo fakultet të UART) dhe 1 përfaqësues nga Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës.
3. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Përfaqësuesi nga Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës emërohet nga Rektori.
4. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A, duke dorëzuar kërkesën për vetëkandidim sipas formatit bashkëngjitur këtij vendimi dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 28/08/2025.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Sadik Spahija

Prof. Lorenc Radovani

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjikopulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2025

**KËRKESË
PËR VETËKANDIDIM
PËR
ANËTAR TË KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË
DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN E
ARTEVE**

TË DHËNA TË KANDIDATIT (Plotëso me germa të mëdha, vendos shenjën X në kuti)

Emri			
Mbiemri			
Atësia			
Datëlindja	_____ dita	_____ muaji	_____ viti
Gjinia	M ☐	F ☐	
Nr. personal (NID)			
Pozicioni aktual (student/personel akademik me kohë të plotë/pjesshme)			
Fakulteti	FM ☐	FAS ☐	FAB ☐
Kategoria (pers. ak.: Asistent lektor, Lektor, Profesor)			
Vjetërsia në punë (pers. ak.)			
Nota mesatare (student)			

Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë kërkesë janë të sakta dhe të vërteta. Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht heqjen e së drejtës për kandidim për këtë pozicion.

(Emër, Mbiemër, Firmë)

